

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### "KEBAB FACTORY" SHPK

#### KREU I:

#### ORTAKËT- EMËRTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHËZGJATJA

Sot më datë 02.10.2023, ne Themeluesit, kemi krijuar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Kebab Factory" Shpk.

Themeluesit e shoqërisë Kebab Factory shpk janë:

1. Z. Dritan Jeminaj, i datëlindjes 14.07.1983, lindur dhe banues në Tiranë, me numër personal ID I35714025J, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
2. Shoqëria Beluza Shpk, themeluar në datë 20.02.2023, me Nipt: M31422014R dhe adresë: Rruga "Ismail Qemali", përballë RTV Shqiptar, Kati II, Tiranë, përfaqësuar nga administratori Znj. Lorena Parruca;

Ky Statut krijohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

#### Neni 1

##### Emertimi dhe Forma Ligjore

1.1 Shoqëria tregtare është shoqëri vendase dhe emërtohet "Kebab Factory" shpk (këtu e në vijim Shoqëria), emërtim i cili do të jetë i stampuar dhe në vulën e shoqërisë.

1.2 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme sipas parashikimeve ligjore të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

#### Neni 2

##### Objekti i veprimtarisë

Aktivitetet në fushën e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit me pakicë dhe shumicë i të gjitha produkteve dhe nënprodukteve të mishit, të gjitha llojet e sallamrave si dhe të gjitha produkteve ushqimore të prodhuara nga kjo shoqëri si produkte në natyrë të përbërë, salcave të ndryshme, prodhime brumi, si dhe i të gjithë produkteve të tjera ushqimore, fruta-perimeve, pijeve të ndryshme, etj. Import-eksport i produkteve të ndryshme ushqimore dhe joushqimore. Blerja dhe shitja e kafshëve, import-eksport me shumicë e me pakicë i tyre, si dhe i të gjitha produkteve që i nevojiten kësaj kompanie si lëndë e parë apo edhe për të tretë. Aktivitetin e shfrytëzimit të thertoresh për therjen e kafshëve të blera nga shoqëria për

nevojat e saj dhe shërbim therje për të tretë. Tregtim me pakicë dhe shumicë i mishit të freskët dhe i nënprodukteve të gjeneruara nga impianti i therjes dhe përpunimit të mishit. Mbarështimi i kafshëve të gjalla, transport i tyre dhe i gjithë produkteve të prodhuara prej tyre. Aktivitet në fushën e bar-restorant dhe fast-food. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura më sipër.

### Neni 3

#### Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë shoqërisë është në adresën: Pezë e Vogël, Zona Kadastrale 2952, Nr. Pasurie 33/7, Tiranë.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, mund të krijohen ose mbyllen (në rast se janë çelur), seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj. Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë si degë apo përfaqësi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

### Neni 4

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

### Neni 5

#### Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon :

Lloji i kontributit është në para në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota si më poshtë;

- **Z. Dritan Jeminaj**, është zotërues i 1 (një) Kuote, që i korrespondon 50 % (pesëdhjetë për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.
- **Shoqëria Beluza shpk**, është zotërues i 1 (një) Kuote, që i korrespondon ne 50 % (pesëdhjetë për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.

Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer dhe nënshkruar tërësisht nga ortakët e shoqërisë.

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

### Neni 6

#### Transferimi i kapitalit

6.1 Kuotat e kapitalit te Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo



kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

6.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

6.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### Neni 7

#### E drejta e parablerjes

Transferimi për çdo arsye, tërësisht ose pjesërisht i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakut tjetër, i cili mund të ushtrojë këtë të drejtë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomande, i cili përmban cmimin, blerësin e mundshëm dhe menyren e pagimit.

Në rast se ortakun nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se ka hequr dorë prej të drejtës së parablerjes.

Në rastin e mosushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ortakun, Ortakun që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emrin e blerësit dhe kushtet të cilat nuk duhet të jenë me të favorshme se sa ato të ofruara ortakut tjetër të shoqërisë.

#### Neni 8

#### Organet e shoqërisë

Organi vendimmarres i shoqërisë "Kebab Factory" Shpk është Asambleja e Ortakëve e përbërë nga ortakët e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha

vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 9

##### **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit për shoqëritë tregtare.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

#### Neni 10

##### **Mënyra e thirrjes**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



## Neni 11

### Kërkesa nga ortakët e pakicës

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit për shoqëritë tregtare.

Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 14 të statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

## Neni 12

### Përfaqësimi në Asamble

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori/ët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 13

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit 9901, date 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të

përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 14

#### Marrja e vendimeve

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit për shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

#### Neni 15

#### Procesverbalet e mbledhjes së Asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

#### Neni 16

#### Administratori

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar administrohet nga një ose disa persona fizikë. Administratori i shoqërisë emërohet me vendim të ortakut të shoqërisë. Afati i qëndrimit në detyrë i administratorit të shoqërisë është për një periudhë 5 (pesë) vjecare.

Administratori i kësaj shoqërie emërohet **Elvis Kovaçi**, shtetas shqiptar, lindur në Lushnjë dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 10.11.1988, madhor, pajisur me Leternjoftim/pasaportë nr personal I81110047R me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Administratori/et e shoqërisë i kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që u njeh ligji shprehimisht Asamblese së Ortakëve ose të tretëve. Administratori/ët kanë përgjegjësi ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkeljet e ligjeve, statutit apo shkeljeve të kryera gjatë administratimit. Administratori në rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogaritë vjetore etj.



## BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE

### Neni 17

Viti fiskal fillon në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor të çdo viti.

Për nxjerrjen e rezultatit kontabël të shoqërisë, mbi bazën e aktivitetit dhe pasivitetit, ngarkohet nga Asambleja e Përgjithshme një ekspert kontabël i autorizuar.

### Neni 18

#### Ekspertet kontabel të autorizuar

Auditimi i brendshëm i Shoqërisë do të bëhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të caktuar për një vit fiskal. Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen nga Asambleja e Përgjithshme me vendim të zakonshëm.

### Neni 19

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bërë me saktësi dhe duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen në Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, që janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt privat, që ushtron veprimtari tregtare.

Kontabiliteti mbahet në gjuhën shqipe, në monedhën Shqiptare dhe pasqyrohet në librat përkatës. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valute. Shoqëria mund të marrë financime nga ortakët, institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim shoqëria mund të japë si garanci barrë mbi pjesët e kapitalit ose sende të paluajtshme, me autorizim të Asamblesë së Përgjithshme.

### Neni 20

Bilanci Kontabel vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortakët, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të veçantë etj.

### Neni 21

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treta, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë. Asambleja përcakton pjesën që iu takon ortakëve në formë dividendësh.

### Neni 22

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar siç mund të jenë :

- me vendim të Asamblesë së përgjithshme
- humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.
- me hapje e procedurave të falimentimit

d) kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.  
Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

#### Neni 23

Çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht, ortakët duhet ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërtën kompetente për zgjidhjen e tyre janë Gjykatat Shqiptare.

#### Neni 24

Për çfarë nuk është shprehur në këtë statut, do të rregullohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet plotësuese dhe të ligjshme të dhëna nga Asambleja e Përgjithshme.

#### Neni 25


Ky statut u redaktua në 3 kopje origjinale në gjuhën shqipe me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike.

Për regjistrimin e shoqërisë "Kebab Factory" Shpk dhe depozitimin e akteve përkatëse pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, autorizohet Administratori i shoqërisë, *Elvis Kovaçi*, shtetas shqiptar, lindur në Lushnjë dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 10.11.1988, pajisur me Letërnjoftim/pasaportë nr personal I81110047R, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar .

Tiranë, më datë 02.10.2023.


### ORTAKËT THEMELUES

Dritan Jeminaj



Shoqëria "Beluza" Shpk

Lorena Parruca



Administratori

